

Gjendja e gazetarëve në Korçë me shumë probleme

Gazetarët që punojnë në Qarkun e Korçës, si për mediat jo publike përballen me problem të shumta përsa i përket marrëdhënieve me punëdhënësit. Pjesa më e madhe e tyre punojnë pa kontrata sigurmesh shoqërore.

Punëdhënësi mund të heqë ose vendosë në punë një gazetar, pa përfillur ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punësimit, midis punëmarrësit dhe punëdhënësit. Paguhen pak, një gazetarë e vjetër thotë se: “Sa merr një korrespondent gazete në rrethe, merr një pastruese në redaksitë qendrore.”

Për ndjekjen e lajmit në zona të thella priferike, dhe sic dihet Korça gati 60- 70 % të terrenit e ka malor, nuk iu kompensohet nafta dhe benzina.

Nëse kanë probleme me organet e rendit dhe të drejtësisë, këto probleme duhet t’i përballojnë vetë, pa ndihmën e drejtuesve të kompanive mediatike ku punojnë.

E rëndë është gjendja me gazetarët sportivë, në pjesë e mirë e tyre nuk janë paguar prej disa vjetësh.

Ka ardhur koha që shteti të meret me gjendjen e tyre, të ndërhyjë për masën e pagesës dhe nënshkrimin e kontratave të punës.

Ata që informojnë lexuesin dhe shikuesin në çdo orë të ditës dhe të natës, duhet të shpërblehen dhe të mbrohen për punën e tyre.

Unioni i Gazetareve DEGA KORCE